GREEN Solution
Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

EMËRTIMI I PROJEKTIT:

FUNKSIONIMI I SPITALIT "SANTE PLUS HOSPITALS".

VENDODHJA:

QARKU TIRANË, BASHKIA TIRANË, NJËSIA BASHKIAKE NR. 7, ZOGU I ZI, ZONA KADASTRALE NR. 8310, NR. I PASURISË 6/1292.

(Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, ID 12.2 "Spitalet", Kapaciteti kufi për lejet e mjedisit tipi B: Të gjitha instalimet).

Kërkues:

"SANTE PLUS GROUP" SHPK

NIPT: L01327007G

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:

"GREEN Solution"

Laert Shehu

Administrator

GREEN Solution
TIRANA - ALBANIA

Mars, 2020

TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM

Hyrje

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI..... 2

2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. 9

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS. 13

4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. 28

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE..... 29

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS..... 29

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME. 29

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS..... 29

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË). 300

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti ne vleresim eshte Spitali "SANTE PLUS HOSPITALS" i ndodhur brenda qytetit te Tiranes, ne Njesine Bashkiake Nr. 7, Zogu i Zi, zona kadastrale 8310, nr. i pasurise 6/1292. Ky aktivitet eshte i perbere nga nje 1 godine kryesore 4 kateshe. Për këtë aktivitet nuk kemi vlerësim të sipërfaqes bimore pasi ai ushtrohet ne nje godine ekzistuese, e cila nuk prek bimesi dhe eshte e rrethuar nga objekte te tjera banimi dhe sherbimesh rreth tij. Pothuajse në të gjithë zonat periferike dhe qëndrore të qytetit të Tiranës, vërehet një mungesë e theksuar e hapësirave të gjelbërta dhe parqeve publike. Kryesisht gjelbërimi është i përqëndruar përgjatë segmenteve rrugore, në pjesën e trotuareve, përgjatë shtratit të Lumit të Lanës dhe në disa mini lulishte, të tilla si: Lulishtja "Një Maji", pranë Bluevardit "Bajram Curri", Lulishtja pranë Presidencës, etj. Përsa i përket parqeve të gjelbërta të mirëfillta, në këtë zonë është vetëm Parku Natyror i Liqenit Artificial të Tiranës. Ky është i vetmi vend rekreacioni dhe i zhvillimit të sporteve të lehta, vrapimit, shëtitjes etj.

Bimësia e zonës është ajo e pemëve dhe lulishteve të qytetit si ato të pedonales Rrugës "Murat Toptani", të Rrugës "Sulejman Delvina", të Bulevardit "Gjergj Fishta", të Bulevardit "Bajram Curri", Bulevardi "Zogu I", etj. Ato të parkut Rinia, rrepe dhe bimësi barishtore, si edhe sheshi "Skënderbej", lulishtja tek Sahati, mbrapa pallatit të Operas e rrugët dytësore, të cilat kanë bimësi barishtore dhe pemë të llojeve të ndryshme, si kumbulla, manjola, rrepe, bli, etj. Bimësia e rajonit të Tiranës është e llojit shkurre mesdhetare, tipike e zonave të mesdheut dhe klimës së rajonit. Zona në vlerësim, nuk ndodhet në objekt zone të mbrojtur.

Biodiversiteti dhe habitatet (te pergjithshme)

Biodiversiteti

Shqipëria vleresohet për një larmi të madhe biologjike dhe peizazhore. Origjina të kësaj llojshmërie, është e lidhur me: pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Larmia e madhe e ekosistemeve dhe habitateve (ekosistemeve detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta mesdhetare, pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzjerë, livadhe dhe kullota subalpine e alpine, ekosisteme të maleve të lartë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore dhe shtazore duke përfaqësuar rreth 30% të florës Europiane. Ne percaktimin ligjor kemi kete percaktim: "Biodiversitet (shumllojshmeria biologjik) ose larmi biologjike" është tërësia e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Vizioni ynë për biodiversitetin është: të sigurohet zhvillim normal i flores dhe faunes ne vendjetesat e tyre, që keto peizazhe jo vetem te zbukurojne natyren por dhe të kontribuojë në rritjen në begatinë e vendit e mirëqenjen e popullit. Me më shumë se 3200 lloje të bimëve vaskulare dhe 756 specie vertebrore dhe me rreth 30% të të gjithë florës europiane që zhvillohet në Shqipëri, me të drejtë mund ndjeme krenari për natyrën tonë. Por, ndërsa koncepti i biodiversitetit ka percaktim globale, ruajtja është thjesht një aktivitet lokal.Sa takon ruajtjes te gjithë duhet te ndehemi fajtor per humbjet ne biodiversitet. Shqipëria si një vend që synon të anëtarësohet në BE ka përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime konkrete për të mbrojtur Biodiversitetin e saj, duke qenë se humbja e këtij thesari me të gjithë ekosistemet, krijon efekte negative në ekonomi duke rrezikuar në një farë mënyre atë. Për të ndaluar humbjen e biodiversitetin në Shqipëri, duhet të ketë një sipërmarrje të përbashkët "Biodiversiteti është ekzistenca jonë, është ekzistenca juaj është me rëndësi përfshirja e komunitetit, në mënyrë që të ruhet kjo pasuri që në fund na bën të ndihemi kaq shumë krenarë." Përpjekjet për të mbrojtur tokat natyrore dhe ujërat tona duhet të jenë fokusi i interesit dhe veprimtarisë së të gjithëve dhe vlerësimi i statusit të ruajtjes së llojeve të veçanta është çelësi për të kuptuar gjendjen e përgjithshme të florës dhe faunës dhe vendosjen e prioriteteve për ruajtjen", Humbja e biodivesitetit si problem global, përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote. Ekspertet japin alarmin duke konkluduar: se nëse do te vazhdohet me këtë trend, humbja e biodiversitetit do te ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri ne 10 % te llojeve te njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonomine botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave te njeriut plotësohen nga resurset biologjike. Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shume arsye, por me këtë rast do te përmendim vetëm disa prej tyre: Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë, Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kane jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri, Mjedisi ndotet në tokë, ujë dhe ajër. Ky është një problem i madh i kohës sonë. Kështu përgjegjësit kryesor të ndotjes së ujërave të detit janë shkarkimet urbane, industriale, bujqësore të zonave më të zhvilluara, si edhe shkarkimet e naftës në zonat ku ajo nxirret. Edhe zonat e bregdeteve dhe ishujt rrezikohen nga ngrohja e klimës: shkrirja e një pjese të akullnajave çon në rritjen e nivelit të detit. Ndotja e ajrit dëmton jetën e njeriut, dëmton sytë, rrugët e frymëmarrjes. Sot në shumë vende ka agjenci që matin

shkallën e ndotjes së ajrit dhe kur kjo është e lartë marrin masa si mbyllja e fabrikave, ndalojnë qarkullimin e makinave etj. Disa qytete të Shqipërisë, sidomos Tirana dhe Elbasani janë shumë të ndotur. Era e rëndë, thithja e ajrit të ndotur janë disa nga problemet e përditshme me të cilat përballen qytetet, ku trafiku i automjeteve, shkarkimet industriale dhe ngrohja e banesave janë të përqëndruara në zona të ngushta: kush banon në qytet e ndjen menjëherë problemin e ndotjes së mjedisit. Mbetjet urbane përmbajnë edhe produkte kimike që zbresin në thellësi dhe ndotin burimet e nëndheshme ujore. Në qytete, ndodhen gjithashtu edhe kantierët e ndërtimit, që shpesh derdhin nëpër lumenj sasi të mëdha materiali ndërtim. Zhvillimi i turizmit ka ndikime direkte në biodiversitet. Tashme vendi yne eshte kthyer nje nje destinacion te njohur i orientuar tek ekoturizimi. Per fatkeq hapësira bregdetare ka qenë pre e shkatërrimeve që kane rrjedhur nga përdorimi turistik i këtij rajoni. Pasojat më të mëdha të këtyre shkatërrimeve kanë të bëjnë me mbingarkesat ndërtimore të natyrës dhe të peizazhit. Të gjitha këto probleme konfliktuale që lindin midis turizmit dhe biodiversitetit ne zonen bregdetare eshte shume e rendesishme ti parandalojme ne zonen malore dhe ne peizazhet pyjore ekzistuese.

Gjëndja e disa specieve aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

Nëpërmjet një sistemi monitorimi do të arrihet vlerësimi i gjëndjes së disa specieve aromatiko-mjekësore të cilat janë në rrezik zhdukje si dhe përshkrimi i gjëndjes së Sherbelës në rajonin qëndror të vendit tone, do të na japin të dhëna të plota, për bimët aromatiko-mjekesore. Me ane te ketij studimi synohet; Se pari, të identifikohen faktoret kryesore sociale, ekonomike, dhe politike që kanë çuar drejt pakesimit. Së dyti, duke përdorur një analizë social-ekonomike, duke vleresuar rëndësinë sociale dhe ekonomike për mbledhesit e këtyre prodhimeve. Se treti, të ofrojmë rekomandime për mbareshtimin në menyre të qëndrueshme dhe për të rritur të ardhurat e popullatës. Menazhimi dhe zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të specieve aromatiko-mjeksore mundet të jetë një alternativë për rritjen e nivelit të të ardhurave plotësuese në zonat rurale , të tilla si;

- Kapacitieti i kufizuar i aftesive prodhuese
- Frangmentimi i theksuar i tokës në mesatarisht 3-4 ngastra për ferme
- Vështirësi të shumta financiare për sigurimin e mjeteve të nevojshme të prodhimit
- Mundesi të pakta për sigurimin e kredive
- Mungesa e një shërbimi ekstensioni.

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qëndrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune-Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit "Mbi gjuetinë dhe

peshkimin në ujërat malorë" u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombetar "Mali i Dajtit" dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detarë/bregdetarë, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Referuar verifkimeve të kryera në portalin gjeohapësinor shtetëror "asig.gov.al", kemi konstatuar se zona ku ushtrohet aktiviteti, nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe me status te veçantë. Objekti ku zhvillohet aktiviteti ndodhet në një distancë rreth 7 km larg në vijë ajrore nga zona e mbojtur, "Parku kombëtar "Mali i Dajtit"". Më poshtë po paraqesim një ilustrim me ortofoto të zonës në studim së bashku me distancën qe ruan nga zonat e mbrojtura.



Monumentet Natyrore të Rrethit Tiranë.(Sipas VKM-së 676)

Bokerimat e Mustafa Koçajt	Gryka e Murdarit
Shpella e Shutresë	Shkalla e Tujanit
Shpella e Zezë (Pëllumbasit)	Bokerimat e Mnerit
Shpella e Valit	Rrapi i Priskës
Tarraca detare e Dajtit	Rrapi i Kranës – Dajt
Karsti i Malit me Gropa	Rrapi i Ndroqit
Gryka e Skoranës	Arra e Babë Myslymit

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT ***VITI 2014-MARS***

Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastër	Gjirokastër	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
	KATEGORIA I	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)			SHUMA I	2	4,800.0
3	II	Shkodër	Shkoder	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Kruje	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjocaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali I Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali I Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastër, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, date 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
	KATEGORIA II	Park Kombetar - Kategoria II (PK)			SHUMA II	15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0

21	III	Gjirokastër	Gjirokastër	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastër	Gjirokastër	Zhej	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676,datë 20.12.2002	750	0.0
	KATEGORIA III	Monument Natyre - Kategoria III (MN)			SHUMA III		3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2,datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684,datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukes	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		34,886.8
	IV/1	Park Natyror Rajonal					
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, date 03.04.2013	1	4,206.0
	KATEGORIA IV	Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)			SHUMA IV	23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80,datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680,datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682,datë 02.11.2005	1	23,027.0
52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	KATEGORIA V	Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	96,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	2,200.0
	KATEGORIA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve te Natyrore te Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)			SHUMA VI	4	18,245.0
	TOTALI i ZM				16%	799	460,060.9

	Sip. Republikës	2,874,800.00		ZM pa Sip.Detare	15.54%		446,799.7
				Sip. Detare, Ha	0.5%		13,261.2
					Karaburun-Sazan		12,428.0
					Butrint		833.2
				Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%	119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
b	VKQ	Vendim i Keshillit te Qarkut
c	MB	Ministria e Bujqesise
d	ZM	Zone e Mbrojtur

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413,datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liqeni I Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt 03.07.2013	15,118.6
	TOTALI				%/Totali Republikës	3.42%	98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA
SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.mjedisi.gov.al/

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit te aktivitetit, i cili zhvillohet ne Bashkiane Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 7, Zogu i Zi, Zona Kadastrale 8310, nr i pasurise 6/1292, ka burime ujore te identifikuara, por jo ne siperfaqen e zhvilluar, ato ndodhen ne nje distance te konsiderueshme, te tille qe ndikimet e ketij aktiviteti nuk arrijne efektet e tyre ne keto burime ujore. Spitali "SANTE PLUS HOSPITALS" ndodhet brenda qytetit te Tiranes dhe nuk ndodhet ne brendesi te burimeve ujore te rendesishme si Lumenjte kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Ne kete zone identifikohen keto burime ujore: Lumi i Lanes, i cili shtrihet ne jugperendim te siperfaqes rreth 1.64 km larg, Lumi i Tiranes, i cili shtrihet ne veri te siperfaqes rreth 1.83 km larg ne vije ajrore dhe Liqeni Artificial i Tiranes, i cili ndodhet ne juglindje te siperfaqes te objektit ku zhvilohet aktivitetit rreth 2.5 km larg ne vije ajrore.

Distancat qe ruan objekti me burimet ujore te zones



Fragment nga Plani Urbanistik i Bashkisë Tiranë
Objekti bën pjesë në njësinë strukturore TR/420

Cilesia e lumenjeve
(Informacione të përgjithshme bazuar në studimin Kombëtar vjetor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit)
Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

BASENI ISHËM - ERZEN
Monitorimi i këtij baseni realizohet në 10 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij, të cilat janë paraqitur në formë tabelare si vijon:

Oksigjeni i tretur
Vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon ku shihet qartë që stacionet, të cilat janë të varfëra në oksigjen janë T2 – Ura Kthesa e Kamzës duke u klasifikuar në Klasën IV- Gjendje e varfër, L2 – Yrshek – Ish Dogana ka një vlerë mesatare 3.87 mg O/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e varfër dhe në tre stacionet e Ishmit me vlera të ulëta. Lumi Erzen paraqitet të jetë me ujëra të pasur me oksigjen duke u klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.

OKSIGJENI I TRETUR



Nevoja Biokimike për oksigjen

Nevoja Biokimike për oksigjen është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet të konsumohet nga organizmat biologjike aerobike, të cilat ndodhen në sasinë e kampionit në shishen e pajisur me oxitop. Inkubimi ne 20 °C realizohet për 5 dite ku vlera e matur shprehet në mg O/litër. Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve, tregues i shkallës së ndotjes. Tejkalim të vlerës limite për parametrin Nevoja biokimike për oksigjen kemi në stacionet L2 – Ish Dogana Kashar ku vlera mesatare e ekspeditave të realizuara është 41 mg O/l një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje shumë të lartë duke e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe ku duhet të merren masa të menjëhershme (>18 mg/l). Tejkalim të normës kemi edhe në tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar në Klasën IV – Gjendje e varfër. Lumi Erzen paraqitet në gjendje të mirë – Klasa II ne tre stacionet e monitoruar.

NEVOJA BIOKIMIKE PER OKSIGJEN



Përmbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metodën spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Grafiku paraqet të dhënat mesatare të ekspeditave të realizuara. Në stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës limite për përmbajtjen e amonjakut në stacionin L2 – Lanabregas me vlerë mesatare 13.58 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në klasën V – Gjendje e keqe, në të tre stacionet e Ishmit të cilat klasifikohen ne Klasën V – Gjendje e keqe dhe në stacionin Er2 – Ura e Beshirit Ndroq me një vlerë mesatare të përmbajtjes së amonjakut 0.59 mg/l – e cila ndodhet në kufirin e Klasës III – Gjendje e moderuar.

PERMBAJTJE E AMONJAKUT



Përmbajtja e nitriteve

Siç vihet re edhe ne grafikun e mëposhtëm, përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në të gjitha stacionet e këtij baseni.

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar.





Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare vjetore, vlerësojmë se kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve në stacionin L2 – Lanabregas në vlerën 1.47 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe.

Tejkalim të vlerës limite kemi edhe në të tre stacionet e Ishmit duke e klasifikuar këtë lumë në klasën e V – Gjendje e keqe. Stacionet e Lumit Erzen nuk e tejkalojnë normën e lejuar.



Përmbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare të ekspeditave të realizuara vlerësojmë se stacionet L2 – Lanabregas dhe të tre stacionet e Ishmit tejkalojnë vlerën limite të klasës së III duke klasifikuar Lanabregasin në Klasën V – Gjendje e keqe dhe Lumin Ishëm në Klasën IV – Gjendje e varfër.

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vlerësojmë se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane, të cilat derdhen direkt të patrajtuara sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë. Baseni Ishëm – Erzen klasifikohet në Klasën V – Gjendje e keqe.



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit (Faqja Zyrtare).

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

3.1 INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikoje, identifikoje, vleresoje dhe parandaloje ose minimizoje ndikimin ne mjedis te projektit te propozuar.

Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efiçence;
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit;
- Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te Disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit;

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;
- Ndihmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te veçante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndrushuar.**
- **Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".**
- **Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit", i ndryshuar**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**

- **Ligji Nr.10266 per disa ndryshime ne ligjin 8897 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".**
- **Ligji Nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006.**
- **Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".**
- **Ligji Nr. 124/2015 datë 12.11.2015 "Për efiçencën e energjisë".**
- **Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".**
- **Vendim i KM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis".**
- **Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".**
- **Vendim i KM Nr. 419, date 25.06.2014 "Për miratimin e kerkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja".**
- **Vendim i KM Nr. 435, date 12.9.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise".**
- **Vendim i KM Nr. 798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore"**
- **Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve".**
- **Vendim i KM Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare".**
- **Vendim i KM Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të Monitorimit të Mjedisit".**
- **Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave".**

Sqarim:

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteteve, te cilat duhet te pajisen me leje mjedisore te tipit A, B ose C. *(Konkretisht ne ID 12.2 Spitalet, Kapaciteti kufi per lejet e mjedisit tipi B: Te gjitha instalimet.)*
Bazuar ne shtojcat I dhe II te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", ky aktivitet nuk perfshihet ne listen e aktiviteteve qe i nenshtrohen procedures paraprake ose te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.
Permbledhja joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

3.2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Kjo permbledhje joteknike e raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit "SANTE PLUS GROUP", me NIPT: L01327007G. Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen per hartimin e proçedures se konsultimit me publikun prane AKM dhe do te aplikoje prane QKB-AKM per pajisjen me Leje Mjedisore te Tipit B per aktivitetin e Funksionimit te spitalit Sante Plus Hospitals.

Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i Spitalit Sante Plus. Ky aktivitet ndodhet Qarkun Tirane, Bashkia Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 7, Zogu i Zi, Zona kadastrale 8310, Nr. pasurie 6/1292.

Subjekti "SANTE PLUS GROUP" shpk e pajisur me teknologji bashkekohore sipas standarteve europiane, nder te tjera ushtron aktivitet edhe ne vendin tone. Ai ofron sherbime ne fusha te ndryshme te mjekesise, duke permendur, sherbime check up-i, sherbime ne okulistike dhe oftalmologji, ortopodi, onkologji, urologji, otorinaloringologji, gjinekologji, kardiologji, neurologji, dermatologji, stomatologji, kirurgji e pergjithshme, kirurgji plastike dhe kirurgji plastike rikonstruktive, etj. Misioni i ketij spitali eshte qe duke zbatuar me rigorizitet vlerat etike t'u ofrojne te semureve sherbim mjekesor bashkekohor per parandalim, diagnostikim dhe sherim duke patur parasysh thenien: "Arti i mjekimit eshte te sherosh duke i dhene vlere çdo detaji". Subjekti "SANTE PLUS GROUP" e ushtron aktivitetin e tij ne nje godine 4 kateshe, te ndodhur ne Njesine Bashkiake Nr. 7, Zogu i Zi, Tirane, ku ne katin e pare te te cilit ofrohen sherbimet e vizitave dhe kontrolleve te ndryshme. Ky ambient i sherbimit dhe vizitave perbehet nga: dhoma ku kryhen analizat laboratorike (laboratori) te te gjitha llojeve, biokimike, hepatiti, yndyrnat, tiroidet, hiv, gjak komplet etj., dhoma e vizitave dhe sherbimeve stomatologjike, pediatria, otorinolaringologjia, ortopedia, dhoma e kardiologjise, e cila eshte e pajisur me aparatin e ekos, ekg-se, biçikletes, aparatin e stresit, etj. dhe okulistika. Per te vazhduar me tej me ambientit e urgjences, e cila perbehet nga recepsioni, dhoma e vezhgimit, salla e mikrokirurgjise dhe dhoma e marrjes se gjakut per ekzaminin e semundjeve dhe probleme qe mund te kete pacienti i ardhur ne urgjence. Me tej ketyre ambienteve eshte vendosur dhoma e grafise, e cila perbehet nga aparate bashkekohore. Ne katin e pare te ketij spitali ndodhet edhe nje depo magazinuese, ne te cilen vendosen perkohesisht te gjitha koshat e mbetjeve spitalore deri ne momentin e marrjes se tyre nga subjekti i licensuar per trajtimin e metejshem te tyre. Subjekti ka lidhur kontrate per menaxhimin e mbetjeve spitalore me subjetin ECO RICIKLIM Sh.p.k. Ne kete kat eshte vendosur edhe dhoma e autoklaves ku behet sterilizimi i mjeteve, e cila funksionon me energji elektrike. Ne katin e dyte te godines se spitalit eshte vendosur dhoma e imazherise se pergjithshme dhe dhoma e vizitave obstetrik/gjinekologji. Per te vazhduar me tej me ambientin e lazerit, dhome ne te cilen eshte instaluar aparati i lazerit, i cili perdoret per nderhyrjet dhe sherbimet e estetikes. Ne katin e trete jane te vendosura dhomat e pacienteve dhoma e mjekut dhe infermeres se turnit, ndersa ne pjesen tjeter te ketij kati ndodhet dhoma e gastroenterologut, ku kryhen ekzaminimet e stomakut dhe zorres se trashe, ne kete dhome eshte instaluar aparati fibrogastroskop dhe aparati i sondes. Perballe kesaj dhome ndodhen ambientet e sallave te operacionit dhe salla e lindjes. Ky ambient fillon me korridorin e gjate, ku ne anen e majte ne hyrje te tij jane vendosur mbulesa kepucesh, shapka, maska, veshje te posaçme, te cilat vendosen perpara se personeli te hyje ne sallat e operacionit, per te vazhduar me dhomen e zhveshjes se mjekut kirurg, zonen e reanimacionit dhe sallat e operacionit. Jane 3 salla operacioni dhe nje salle lindjeje ne kete kat. Salla e lindjes se bebeve perbehet nga inkubatori, aparati i respirimit, sterilizatori etj.,

ndersa sallat e oparacioneve jane te pajisura me aparate televizive ne sherbim te nderhyrjeve te ndryshme kirurgjikale qe kryhen, elektrobisturi, aparati elektroshok, sistem ventilimi, ndriçues, tavolina per vendosjen e mjeteve sterile, ene dhe pajisje per vendosjen e mjeteve te perdorura gjate nderhyrjes, etj. Ne katin e fundit te godines se spitalit eshte vendosur farmacia e pergjithshme, e cila kryhen furnizimin me medikamente te te gjithe spitalit, si dhe sektoreve te ndryshem te saj.

Kjo permbledhje joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti nga funksionimi i tij.

Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit




Sante Plus General Hospital Albania



\Harta topografike e rajonit. Nomeklatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-88-(250-D)



Foto te ambjenteve te jashtme dhe te brendshme te spitalit

Recepsioni dhe holli i pritjes ne hyrje te spitalit

Ambientet e sherbimeve dhe vizitave

Laboratori klinik-biokimik





Urgjenca



Radiologjia



Autoklava ku behet sterilizimi i mjeteve

Dhoma e vizitave obstetrik/gjinekologji

Ambienti i lazerit

Dhoma e nenave pas lindjes

Dhoma e ekzaminimit te stomakut dhe zorres se trashe (Gastroenterologu)

Sallat e operacioneve kirurgjikale dhe lindjes se nenave

Reanimacion

Salle lindje

Neonati, dhoma e qendrimit te bebeve pas lindjes



Salle operacioni

Sistemi qendror i ngorhjes dhe ajrimit te sallave te oparacionit

Koshat e mbetjeve spitalore

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e

procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te larjes se ambjenteve te spitalit, si ujera me Klor pastrues, me acid higjenik, nga larja e solucioneve dhe eneve te perdorura ne laborator, si edhe sterilizimi i pajisjeve dhe mjeteve te punes. Gjithashtu, ujerat qe perbejne pjesen me te madhe sasiore jane ujerat higjeno-sanitare te aktivitetit human te spitalit. Keto ujera, grumbullohen ne nje kolektor kryesor dhe aty kryhet klorinimi i tij dhe me pas keto ujera i bashkohen sistemit te kanalizimeve te gjithe qytetit te Tiranes.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer nga zhvillimi e funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka, nuk ka kaldaje. Ngrohja e ambjenteve te brendshme ne spital kryhet me energji elektrike. Nuk kemi shkarkime ne ajer nga ky aktivitet. Shkarkimet ne ajer mund te jene vetem gjate ndezjes se gjeneratorit, por ai ndizet shume rralle, vetem kur ka shkeputje te energjise elektrike nga rrjeti dhe kur kjo shkeputje ndodh, ai vetendizet nepermjet nje sistemi automatik, duke mos lene asnje moment spitalin pa energji elektrike.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga kompresoret e kondicionereve dhe nga gjeneratori gjate oreve qe ai vihet ne funksion, pra vetem ne rastet e nderprerjes se energjise elektrike. Nuk shkaktohen vibrime.

Ndikimi ne toke
Proceset e punes nuk ndikojne ne toke. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.

Ndikimi ne Biodiversitet
Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e zones. Funksionimi i metejshem i ketij aktiviteti nuk ndikon ne biodiversitetin e kesaj zone. (vetem ne rast te shkarkimit te ujerave te ndotura do te duhej te behej nje vleresim i thelluar).

Ndikimi ne Mjedisin Social
Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete sherbimit qe ofrohet, i cili eshte i pa zevendesueshem, por edhe punesimit. Efekti negativ i aktivitetit eshte ne shkarkimin e ujerave te ndotura urbane. Mbetjet spitalore menaxhohen nga nje subjekt i licensuar per menaxhimin e mbetjeve spitalore. Objekti nuk duhet te funksionoje ne nje zone te rrezikuar nga permbytjet, te rrezikuar nga zjarret (sic jane pyjet), nuk duhet te kete akses askush i paautorizuar dhe duhet te kete siguri fizike.

Mbetjet e prodhuara
Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato spitalore te cilat klasifikohen si mbetje te rrezikshme dhe mbetje urbane nga aktiviteti human. Mbetjet e rrezikshme spitalore, menaxhohen nga nje subjekt i licensuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombetare e Biznesit, ndersa mbetjet urbane menaxhohen duke u depozituar ne vendet e caktuara nga NJQV-ja.

4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.
Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te larjes se ambjenteve te spitalit, si ujera me Klor pastrues, me acid higjenik, nga larja e solucioneve dhe eneve te perdorura ne laborator, si edhe sterilizimi i pajisjeve dhe mjeteve te punes. Gjithashtu, ujerat qe perbejne pjesen me te madhe sasiore jane ujerat higjeno-sanitare te aktivitetit human te spitalit. Keto ujera, grumbullohen ne nje kolektor kryesor dhe aty kryhet klorinimi i tij dhe me pas keto ujera i bashkohen sistemit te kanalizimeve te gjithe qytetit te Tiranes.
Emetimet ne ajer nga zhvillimi e funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka, nuk ka kaldaje. Ngrohja e ambjenteve te brendshme ne spital kryhet me energji elektrike. Nuk kemi shkarkime ne ajer nga ky aktivitet. Shkarkimet ne ajer mund te jene vetem gjate ndezjes se gjeneratorit, por ai ndizet shume rralle, vetem kur ka shkeputje te energjise elektrike nga rrjeti dhe kur kjo shkeputje ndodh, ai vetendizet nepermjet nje sistemi automatik, duke mos lene asnje moment spitalin pa energji elektrike.
Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga kompresoret e kondicionereve dhe nga gjeneratori gjate oreve qe ai vihet ne funksion, pra vetem ne rastet e nderprerjes se energjise elektrike. Nuk shkaktohen vibrime.

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato spitalore te cilat klasifikohen si mbetje te rrezikshme dhe mbetje urbane nga aktiviteti human. Mbetjet e rrezikshme spitalore, menaxhohen nga nje subjekt i licensuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombetare e Biznesit, ndersa mbetjet urbane menaxhohen duke u depozituar ne vendet e caktuara nga NJQV-ja.

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne nje vit.

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance te ngushte, me dhjetera metra, kjo persa i perkete ndikimit te zhurmes, pasi ndikimi ne ujera nese do te shkarkohen ne mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do te shtrinte ndikimin e tij deri ne disa km, ose dhjetra km. Ujerat e gjeneruar nga aktiviteti grumbullohen ne nje kolektor kryesor dhe aty kryhet klorinimi i tij dhe me pas keto ujera i bashkohen sistemit te kanalizimeve te zones.

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedisi i ketij aktiviteti eshte me funksion spital dhe si i tille, ploteson te gjitha kushtet e nje mjedisi te jashtem te rehabilituar, te gjelberuar dhe te mirembajtur. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te merret ne konsiderate mundesia e rehabilitimit te plote te siperfaqeve dhe kthimin e peizazhit ne gjendjen e mepareshme. Per kete çeshtje, nuk kemi marre ne konsiderate, pasi ky aktivitet do te funksionoje si i tille dhe nuk ka projekte per zhvendosjen e tij ne godine tjeter.

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga subjekti per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.
- Te mirembahet dhe te funksionoje sistemi i kanalizimeve dhe i dekantimit te ujerave te ndotura urbane.
- Te menaxhohen ne menyre te integruar mbetjet e ngurta te rrezikshme. (Te rinovohen rregullisht kontratat dhe te mikqyret subjekti ne pergjegjesine e menaxhimit te tyre).
- Te ruhen kushte te larta higjenike ne objekte dhe te pajisen te gjithe koshat me etiketat e mbetjeve te rrezikshme.
- Te mirembahet dhe te kolaudohet sistemi i hidranteve dhe i bombulave te mbrojtjes nga zjarri ne objekt. Te jene funksionale sistemet e alarmit te renies se zjarrit dhe daljet e emergjences.
- Depozita e ujit te jete gjithmone e mbushur dhe funksionale per hidrantet ne raste te nevojshme.
- Te kryhen rregullisht monitorimet e elementeve ndotese per mjedisin perreth.

- Te zgjidhet lenda djegese nafte e paster per gjeneratorin, ne menyre qe te jene te kontrolluara gazet qe emetohen.

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushte normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 1693 Prot. Tiranë, më 4.12.2014

Nr. identifikues 262

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

GREEN Solution TIRANA - ALBANIA

E VLEFSHME PER LEJE MJEDISI TIPI B PER SPITAL PRIVAT TIRANE

" SANITE PLUS GROUP " SHPK.

MINISTRI

Lefter KOKA

MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: **LN-2068-09-2016**
NUIS/NIPT: **L62113034E**

LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Specialiteti

Laert Shehu
Digitally signed by Laert Shehu
Date: 2020.01.08 14:27:45 +01'00'

GREEN Solution TIRANA - ALBANIA

Nënshkrimi i sportelit:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES - QKB - QENDRORE - PORTALI I SHËRBIMEVE TË BIZNESIT - QENDRA KOMBËTARE

Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.